

STRATEGJIA
e
KËSHILLIT TE KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE
2017-2022



Përmbajtja

Hyrja	4
1.Misioni /Vizioni	5
Kompetencat dhe përgjegjësitë e KKTK-së.....	5
2. Përshkrimi i gjendjes - SWOT Analiza.....	7
2.1 Gjendja e trashëgimisë kulturore.....	8
Trashëgimia Arkeologjike.....	8
Trashëgimia Arkitekturale	10
Trashëgimia e Luajtshme	11
Trashëgimia jomateriale (shpirtërore).....	13
Peizazhet kulturore.....	14
2.2 Korniza ligjore	14
Baza ekzistuese ligjore për KKTK.....	15
Avancimi i Kornizës ligjore për punë efektive dhe efikase të KKTK	15
Kudri ligjor për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore	16
Kudri nënligjor që rregullon mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore	16
Vështirësitë që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit	17
2.3 Struktura organizative e KKTK.....	18
Burimet Njerëzore.....	18
2.4 Buxheti/financat	19
2.5. Infrastruktura, teknologjia, komunikimi	20
3. Objektivat	21
4. PLANI I VEPRIMIT	25

LISTA E SHKURTESAVE

KKTK – Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

MKRS – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

LTK – Ligji për Trashëgimi Kulturore

LZVM – Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

LQHP – Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

KZM – Këshilli Zbatues dhe Monitorues

UNESCO - United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

KE – Këshilli i Evropës

Hyrja

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore - KKTK funksionin nga viti 2009. Me qëllim të operacionalizimit të punës së tij dhe arritjes së objektivave të përcaktuara me sukses të plotë dhe me profesionalizëm, KKTK ka hartuar Strategjinë 2017-2022.

KKTK në muajin tetor të viti 2016, ka themeluar grupin punues për hartimin e Strategjisë 2017-2022, i cili në përbërjen e tij ka të gjithë punonjësit e sekretariatit dhe disa anëtarë të bordit.

Strategjia është hartuar duke marrë për bazë një gamë të gjerë dokumentesh relevante, si dokumentet e hartuar me asistencën e konsulentëve të jashtëm, rregulloret e brendshme, planet dhe raportet vjetore aktuale, Ligjin për Trashëgimi Kulturore, Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027, gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore dhe aspekte të tjera nevojshme për analizën e gjendjes.

Grupi punues ka realizuar SWOT analizën e punës së deritanishme të KKTK duke identifikuar në mënyrë cilësore dhe të saktë, sukseset dhe dobësitë e institucionit, por edhe mundësitë dhe rreziqet me të cilat KKTK mund të përballet në të ardhmen.

Si rezultat i SWOT analizës është realizuar arritja e pesë (5) objektivave institucionale për periudhën 2017-2022. Me anë të këtyre objektivave KKTK synon të përmbushë mandatin dhe detyrat që ka karshi ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Strategjia është dokument udhërrëfyes për veprimtarinë e KKTK gjatë periudhës 2017-2022 duke u bazuar në parime të qëndrueshme profesionale. Prandaj, për të parë progresin e zbatimit dhe sfidat e hasura gjatë implementimit, Strategjia e KKTK 2017-2022 dhe Plani i Veprimit do të rishikohen, së paku një herë në vit ose/dhe sipas nevojave të institucionit.

1. Misioni /Vizioni

KKTK angazhohet për një institucion të qëndrueshëm, të pavarur dhe inovativ përmes angazhimit të drejtpërdrejtë në ruajtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. KKTK angazhohet që trashëgimia kulturore të jetë në shërbim të komunitetit, pasi që vet komuniteti është krijuesi dhe ruajtësi më i mirë i saj. Të gjitha vendimet që KKTK do të marrë do të jenë transparente dhe në të mirë të qytetarëve dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Krijimi i hapësirës institucionale adekuate përmes qasjes së paanshme dhe profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore duke respektuar të gjitha kriteret dhe standardet vendore dhe ndërkombëtare, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore gjithashtu është mision që do të ndikojë të kemi një trajtim profesional ndaj trashëgimisë kulturore.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e KKTK-së

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës ka në kuadër të mandatit, këto detyra dhe përgjegjësi të punës:

- Shqyrton, vlerëson, aprovon apo refuzon trashëgiminë kulturore të propozuar për shpallje në mbrojtje të përhershme;
- Propozon hartimin e Politikës Nacionale për Trashëgimi Kulturore;
- Vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse;
- Asiston Kuvendin e Republikës së Kosovës në plotësim- ndryshimet e ligjeve që kanë të bëjnë me trashëgimi kulturore;
- Siguron mjete apo donacione për intervenime dhe çështje të tjera në trashëgimi kulturore;
- Themelon Komisione të pavarur për vlerësimin e kompensimit të aseteve në rast shitblerje, shpronësimi apo për ndonjë humbje financiare që ka ndodhur në aseteve të evidentuara që kanë karakter të mbrojtjes së përkohshme ose përhershme;
- Mbikëqyr Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) gjatë hartimit të listës së aseteve të trashëgimisë kulturore në rrezik;
- Identifikon dhe i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës prioritetet vjetore për mbështetje financiare të trashëgimisë kulturore;
- I propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës ndërmarrjen e masave të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe i ofron asistencë teknike Qeverisë në

te gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore në Republikën e Kosovës nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria;

- Bashkëpunon me MKRS dhe Institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si UNESCO, Këshilli i Evropës etj, për çështje të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin për Trashëgimi Kulturor, ligjet e tjera në fuqi si dhe konventat dhe standardet ndërkombëtare;
- Bashkëpunon me Këshillin Zbatues dhe Monitorues (KZM) mbi çdo çështje që ka lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës sipas Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;
- Rivlerëson apo rishikon Qendrën e mbrojtur historike të Prizrenit me të gjitha elementet e saj, bazuar në Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.
- Detyra të tjera të parapara me ligj.

2. Përshkrimi i gjendjes - SWOT Analiza

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore ka identifikuar fushat e nevojshme për analizën e gjendjes në përgjithësi dhe në veçanti ato që kanë ndikim në veprimtarinë institucionale të tij. Çështjet që janë marrë në shqyrtim dhe i janë nënshtruar analizës së gjendjes sipas SWOT metodologjisë për këtë rast janë: gjendja e trashëgimisë kulturore, korniza ligjore, struktura organizative e KKTK, buxheti/financat, infrastruktura, teknologjia, komunikimi, burimet njerëzore, etj.

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Pavarësia institucionale e KKTK - Kodi i pavarur buxhetor - Realizimi i detyrave kryesore (sipas mandatit) - Trashëgimia kulturore është prioritet shtetëror (Programi i Qeverisë 2015-2018 dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2018) 	<ul style="list-style-type: none"> - Moszbatimi i Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe ligjve tjera relevante - Mungesa e bashkëpunimi ndërinstitucional - Mosdorëzimi i projekteve për vlerësim - Numri i ulët i stafit - trajtimi joprofesional i trashëgimisë kulturore - Infrastruktura, teknologjia dhe komunikimi
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i kornizës ligjore - Promovimi i diversitetit kulturor dhe peizazheve kulturore - Burimet njerëzore - Reforma institucionale - Vendosja e bashkëpunimi dhe partneritetit me institucione ndërkombëtare - Digjitalizimi i shërbimeve - Identifikimi, propozimi në Kuvendin e Kosovës për mbështetje financiare të trashëgimisë kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> - Buxheti i pamjaftueshëm - Keqpërcaktimi i prioriteteve - Shkatërrimet, humbja e trashëgimisë kulturore - Mungesa e kontrollit, përgjegjshmërisë institucionale - Vështirësitë e sigurimit të fondeve, donacione

Tabela 1.SWOT analiza

Identifikimi i këtyre çështjeve vjen si rezultat i analizës së gjendjes në KKTK dhe zhvillimeve në fushën e trashëgimisë kulturore. Lidhur me këtë ekziston dakordim i plotë se pikërisht janë këto çështje që duhet të merren parasysh dhe të adresohen pas analizës së thukët, me qëllim të organizimit të suksesshëm të veprimtarisë së KKTK në periudhën e Strategjisë 2017-2022.

2.1 Gjendja e trashëgimisë Kulturore

Gjendja e trashëgimisë kulturore duke përfshirë të gjitha kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore nuk është e mirë, janë bërë hapa të rëndësishëm mirëpo në nivelin e përgjithshëm ka hapësirë të theksuar që lenë për të dëshiruar. Buxheti i ndarë për trashëgimi kulturore nuk është i vogël, por është i pamjaftueshëm si dhe duhet ngritur mekanizmat e kontrollit dhe të sigurohet cilësia në trajtimin profesional në përputhje me standardet dhe kriteret ndërkombëtare. Po ashtu duhet të sigurohet vlerësim profesional dhe ligjor i të gjitha projekteve në fushën e trashëgimisë kulturore.

Trashëgimia Arkeologjike

Trashëgimia arkeologjike është njëra nga pesë kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore.

Hynë në kuadër të trashëgimisë kulturore materiale, trashëgimia kulturore arkeologjike përbehet nga monumentet, rezervatet dhe objektet e trashëgimisë së luajtshme. Republika e Kosovës është mjaft e pasur me trashëgimi kulturore arkeologjike nga periudhat më të hershme historike. Zbulimet arkeologjike kanë treguar se territori i Republikës së Kosovës është i pasur me kultura materiale nga paleoliti në vazhdimësi deri në periudhat më të reja.

Disa nga lokalitetet më të rëndësishme arkeologjike në Republikën e Kosovës janë: Ulpiana, Dresniku, Runiku, Reshtani, Vlashnja, Bardhoshi, Gllamniku, Tushila dhe lokalitete të tjera. Gjendja e trashëgimisë kulturore arkeologjike është relativisht e mirë, kjo për faktin që viteve të fundit ka pasur ndarje më të mëdha buxhetore nga shteti si dhe përkrahje nga shtete të tjera si: Gjermania, Franca, Turqia, Italia etj. Janë bërë gërmime arkeologjike anekënd Kosovës, me karakter shpëtimi dhe shkencor, në masë të madhe është bërë inventarizimit i kësaj trashëgimie kemi edhe përpjekje për të promovuar këto vlerave të trashëgimisë kulturore arkeologjike. Problem vazhdon të jetë gërmimi klandestin, që në disa raste identifikohet më kohë dhe arrin të parandalohet

kurse në disa raste të tjera kjo dukuri bëhet gjatë natës dhe nuk arrin të identifikohen personat që bëjnë këtë krim.

Pjesa me e madhe e aseteve të trashëgimisë kulturore arkeologjike janë prona private, që është një sfidë dhe problem për menaxhimin dhe administrimin më të mirë të këtyre aseteve. Prandaj në vitet vijuese shteti duhet të ketë si prioritetet ndarjen e mjeteve financiare për shpronësim. Prioritetet për shpronësim janë: Ulpiana dhe Dresniku, pasi që kanë një sipërfaqe më të madhe të shtrirjes dhe kanë një rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore në Republikën e Kosovës.

Duke mos përjashtuar edhe asete të tjera anekënd Kosovës. Të gjitha eksponatet arkeologjike të cilat zbulohen nga gërmimet duhet të prezantohet në muze dhe institucione të tjera. Në Republikën e Kosovës ende nuk kemi një Muze Kombëtar Arkeologjik dhe ka mungesa të mëdha të muzeve nëpër Komuna të Kosovës. Hapja e këtyre muzeve do të mundësonte mbrojtje dhe prezantim më të mirë të trashëgimisë kulturore.

Njëkohësisht do të rriste të hyrat financiare për këto institucione të cilat në një të ardhme të afërt mund të vetëfinancohen nga këto të hyra të cilat gjenerohen nga vizitorët e shumtë. Për të pasur një administrim më të mirë i cili do të ndikoj në ruajtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore arkeologjike, mendojmë se gërmimet arkeologjike duhet të fokusohen kryesisht në gërmime me karakter shpëtimi, ndërsa gërmimet arkeologjike me karakter studimi të kryhen vetëm për periudhat prehistorike dhe historike ku nuk kemi informacione të mjaftueshme shkencore. Gërmimet arkeologjike me karakter studimi duhet të realizohen në bashkëpunim me institucione dhe universitete të njohur arkeologjike perëndimore, me staf të kualifikuar shkencor dhe me metoda bashkëkohore të arkeologjisë moderne.

Si përfundim gjendja e trashëgimisë kulturore arkeologjike është relativisht e mirë, mirëpo duhet rritur përgjegjësia institucionale dhe individuale, të bëhen përpjekje më të mëdha për parandalimin e gërmimeve klandestine dhe trafikimit të artefakteve, gjithashtu orientimet e shtetit duhet në masë të madhe të fokusohen në promovim dhe botime shkencore. Gërmimet arkeologjike kryesisht të bëhen më karakter shpëtimi dhe në raste të caktuara më karakter shkencor, hapja e muzeve arkeologjik.

Asete të trashëgimisë kulturore arkeologjike të përfshira në listën e aseteve në mbrojtje të përkohshme nga MKRS janë katërqindëgjatëmbëdhjetë (416), kurse asete të shpallura në mbrojtje të përhershme nga KKTK janë nëntë (9).

Trashëgimia Arkitekturale

Trashëgimia kulturore arkitekturale është njëra nga pesë (5) kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore. Hynë në kuadër të trashëgimisë kulturore materiale, trashëgimia kulturore arkitekturale përbehet nga ansamblet ose tërësia e ndërtesave, monumentet dhe fushat e konservimit arkitektural. Në kuadër të trashëgimisë kulturore arkitekturale hyjnë të gjitha ndërtesat e kultit fetar, sakral dhe ndërtesat për përdorim familjar (shtëpitë, kullat etj.)

Trashëgimia kulturore arkitekturale daton nga periudha e mesjetës për të vazhduar deri në ditët e sotme. Në Kosovës kemi stile dhe kultura të ndryshme të trashëgimisë kulturore arkitekturale të stilit bizantin, osman, austro – hungarez etj.

Duke pas parasysh periudhat nëpër të cilat ka kaluar Kosova trashëgimia kulturore arkitekturale është shkatërruar në masë të madhe. Në periudhën e paraluftës së fundit 1998 -99 trashëgimia kulturore kryesisht është trajtuar në baza etnike dhe shumica e objekteve dhe monumenteve të cilat nuk i kanë takuar kulturës serbe janë dëmtuar. Në luftën e fundit janë shkatërruar mbi 200 xhami, shumë kulla dhe objekte të tjera të trashëgimisë kulturore arkitekturale. Në vitin 2004 trashëgimia kulturore pësoj shkatërrime të mëdha si rezultat i trazirave që ndodhen në atë kohë. Shumë monumente kryesisht të kultit ortodoks u dëmtuan. Kosova nga buxheti i vet ka ndarë mjete financiare për restaurimin dhe konservimin e këtyre monumenteve kulturore, dhe sot pothuajse të gjitha këto monumente janë kthyer në gjendjen që kanë pasur para vitit 2004. Problem kryesor vazhdon të jetë vet izolimi i këtyre monumenteve dhe mungesa e qasjes shtetërore në këto asete. Të gjitha këto monumente sot ruhen nga Policia e Kosovës më përjashtim të Manastirit të Deçanit i cili ende ruhet nga KFOR-i.

Sot në përgjithësi gjendja e trashëgimisë kulturore arkitekturale vazhdon të jetë jo e mirë, si rezultat i neglizhencës institucionale, përcaktimit të gabuar të prioriteteve, zhvillimit të pakontrolluar urban, mospërkrahja e pronarëve në mirëmbajtjen dhe ruajtën e këtyre aseteve etj. si rezultat i këtyre që u ceken më lartë gjatë vitit 2016 kemi pasur disa raste të rrënimeve dhe shkatërrimeve të trashëgimisë kulturore arkitekturale, në një rast edhe më fatalitet ku në Prizren ka humbur jetën një fëmijë. Këto shkatërrime kanë ndodhur në të gjitha qendrat e mëdha të Kosovës si: Prishtinë, Mitrovicë, Vushtrri, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjilan etj. Gjithashtu shqetësim serioz mbetet edhe gjendja në disa monumente të trashëgimisë kulturore arkitekturale në të cilat shteti ka ndarë mjete dhe ka intervenuar, por ende vazhdojnë të jenë të mbyllura dhe në raste të caktuara janë dëmtuar përsëri (Hamami i Vjetër i Prishtinës, Xhamia e Gurit Prishtinë, Hamami i Gazi Mehmet Pashës

Prizren, Shtëpia e Xhafer Devës Mitrovicë etj). Një kujdes të veçantë shteti duhet të tregojë më Kompleksin Përkujtimorë Adem Jashari në Prekaz, pasi që është trashëgimi kulturore dhe është një nder vendet më të vizituara në Kosovë.

Si përfundim gjendja e trashëgimisë kulturore arkitekturale nuk është e mirë, dhe kjo si pasojë në rend të parë e përgjegjësisë institucionale, orientimet e gabuara në ndërhyrje, kryerja e punëve konservuese dhe restauruese nga kompani ndërtimi dhe të pa licencuara. Institucionet urgjentisht të krijojnë listën e aseteve të trashëgimisë kulturore në rrezik. Mjetet financiare për ndërhyrje konservuese dhe restauruese të ndahen në bazë të prioriteteve shtetërore.

Asete të trashëgimisë kulturore arkitekturale të përfshira në listën e aseteve në mbrojtje të përkohshme nga MKRS janë tetëqindëntëdhjetë (890), kurse asete të shpallura në mbrojtje të përhershme nga KKTK janë katërmëdhjetë (14).

Trashëgimia e Luajtshme

Trashëgimia kulturore e luajtshme është njëra nga pesë (5) kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore. Hynë në kuadër të trashëgimisë kulturore materiale, trashëgimia kulturore e luajtshme përbehet nga të gjitha objektet e luajtshme. Në Kosovë fondi më i madh i takon trashëgimisë kulturore të luajtshme, kjo për arsye të gjeturave arkeologjike dhe objekteve të tjera. Shteti ka inventarizuar një numër të konsiderueshëm të këtyre objekteve, kryesisht objektet që gjenden nëpër muze të ndryshëm. Në Republikën e Kosovës janë zbuluar objekte më vlera të jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore të luajtshme si: Përkrenare, Monedha, Hyjnesha, Terrakota, Shandan, Skulptura e objekte të tjera.

Trashëgimia kulturore e luajtshme sot përballet me probleme të shumta, kryesisht për shkak të mungesës së hapësirës për ekspozim dhe mungesës së depove për sistemimin e objekteve të cilat dalin nga gërmimet arkeologjike. Institucionet përgjegjëse duhet që të bëjnë inventarizimin e të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, duke përfshirë edhe objektet në koleksione private. Mungesa e një inventari të plotë plot të trashëgimisë kulturore të luajtshme bënë që shumë objekte të shkatërrohen, shiten dhe dëmtohen, si dhe në shumë raste nuk dihet kush është pronari, poseduesi etj.

Shitja dhe trafikimi i trashëgimisë kulturore të luajtshme nga persona të paautorizuar është një problem i cili duhet adresuar dhe të krijohen të gjitha kushtet që të parandalohen një dukuri e tillë antiligjore. Koleksionet arkeologjike dhe etnologjike tani e tetëmbëdhjetë (18) vite ndodhen

padrejtësisht në Serbi, përkundër që në kuadër të “Pakos së Ahtisarit” ANEKSI V TRASHËGIMIA FETARE DHE KULTURORE, Neni 6 thuhet se: *“Republika e Serbisë, brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, do t’i kthejë artefaktet arkeologjike dhe etnologjike të cilat janë marrë hua nga muzetë e Kosovës për ekspozim të përkohshëm në Beograd gjatë viteve 1998-1999”*. Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë nga Institucionet ndërkombëtare që të bëjë presion ndaj Serbisë për kthimin e këtyre artefakteve.

Pasi që në bazë të këtij dokumenti po edhe konventave ndërkombëtare Serbia është e obliguar të bëjë kthimin e këtyre artefakteve në vendin e origjinës.

Objekte arkeologjike dhe etnologjike të Kosovës që ndodhen në muzetë e Serbisë janë mbi 1.247 dhe janë të ekspozuara në Muzetë dhe institucione tjera serbe. Ato janë grabitur gjatë periudhave të ndryshme, sidomos gjatë viteve 1998/99. Përveç objekteve arkeologjike dhe etnologjike të marra nga Muzeu i Kosovës dhe Muzetë rajonal, po ashtu dihet se janë grabitur regjistrat dhe filmat, fotot dhe video materialet prodhim dhe pronë e Kosova Filmit, dokumentacione arkivore dhe koleksione nga Arkivat e Kosovës, Biblioteka e Kosovës dhe vepra të ndryshme të artit dhe koleksione nga Galeritë e Kosovës.

Republika e Kosovës duhet të shikojë mundësitë e ratifikimit të konventave ndërkombëtare që lidhen më trashëgimisë kulturore të luajtshme si: Konventën e Hagës, 1954 “Mbi mbrojtjen e vlerave kulturore në rast konflikti të armatosur” dhe protokollin me rregulloren mbi zbatimin e kësaj konvente, Konventa e UNESCO-s, 1970 për “Mjetet e ndalimit dhe parandalimin e importit dhe eksportit të paligjshëm dhe transferimin e pasurisë kulturore. Përmes ratifikimit të këtyre konventave Republika e Kosovës do të bëjë një hap përpara në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me theks të veçantë asaj të luajtshme. Po ashtu, me këto veprime ndërkombëtarizon dhe parandalon eksportin dhe importin e paligjshëm të trashëgimisë së luajtshme.

Si përfundim gjendja e trashëgimisë kulturore të luajtshme nuk është e mirë, kjo si pasojë e qasjes jo të mirë institucionale, mungesës se strategjisë se qartë, mungesës se hapësirave adekuate për ekspozim, mungesës se studimeve dhe botimeve konkrete, mungesës së Ligjit për Muzetë, mungesa e një strategjie të qartë për kthimin e artefakteve arkeologjike dhe etnologjike nga Serbia, parandalimin e trafikimit të trashëgimisë kulturore (KKTK në kuadër të planit të vet për vitin 2017 e ka finalizimin e dokumentit për parandalimin e trafikimit të trashëgimisë kulturore).

Asete të trashëgimisë kulturore të luajtshme të përfshira në listën e aseteve në mbrojtje të përkohshme nga MKRS janë dyqindnjëmbëdhjetë (211).

Trashëgimia jomateriale (shpirtërore)

Trashëgimia jomateriale njëra nga katër fushat përbërëse dhe kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore si karakteristikë kryesore ka qasjen studimore në qendër të së cilës është njeriu dhe ndërthurja e afërt me jetën, traditat dhe besimet. Ajo paraqet rëndësi të veçantë duke përfshirë elemente të krijimtarisë kulturore që në klasifikimet e mëhershme ishin lënë pas dore. Pra, trashëgimia kulturore nuk përfundon me monumente dhe objekte koleksionesh, pasi trashëgimia jomateriale ose shpirtërore paraqet një fushë të gjerë në të cilën bëjnë pjesë traditat, gjuha, vallet, mënyra e jetesës dhe e tërë krijimtaria e trashëguar nga të parët e cila vazhdon të përcillet tek brezat pasardhës, nëpërmjet njohurive e praktikave shoqërore të manifestuara në zejet tradicionale lidhur me jetën, natyrën dhe gjithësinë.

Sidoqoftë, gjendja e kësaj fushe kërkon ndërhyrje dhe angazhim konkret e të shpejtë për shkak të natyrës së ndjeshme dhe me qëllim të shpëtimit të vlerave të saj qoftë për shkak të zhvillimeve globale që vijnë me kohën, ashtu edhe nga harresa dhe rreziku i shuarjes së përhershme. Kosova si vend me begati të shumëllojshme vlerash të kësaj trashëgimie, me anë të qasjes bashkëkohore në klasifikimin e trashëgimisë kulturore, ofron vlera të paçmueshme të krijimtarisë së zhvilluar në shekuj, të cilat arrijnë deri në kohën tonë duke përcjellë me vazhdimësinë e tyre, gjurmë të lashtësisë dhe të epokave historike.

Megjithatë, gjendja reale e kësaj fushe të trashëgimisë paraqitet e pakënaqshme dhe më dobësi e mungesa të shumta në procesin e valorizimit dhe trajtimit profesional të pamjaftueshëm në përgjithësi.

Përpjekjet institucionale janë modeste dhe nuk pasqyrojnë gjithë potencialin apo begatinë e trashëgimisë jomateriale, shpirtërore të vendit. Domsdoshmërisht, del në pah rëndësia e trajtimit serioz si shoqëri dhe shtet si dhe detyrimet ligjore që rezultojnë për mbrojtjen dhe valorizimin e saj. Kështu, në kuadër të Listës së Përkohshme të hartuar nga MKRS, e nënshkruar nga Ministri Kujtim Shala, më dt. 10.10.2016 gjenden edhe pesë (5) asete të kategorizuara si trashëgmi shpirtërore, duke filluar me nr. rendor 1530 dhe përfunduar në nr.1534.

Peizazhet kulturore

Është njëra nga pesë kategoritë e trashëgimisë kulturore, për nga trajtimi dhe qasja institucionale është ndër kategoritë më pakë të prekura, nuk është treguar ndonjë interes i madh për trajtim. Duke pas parasysh qasjen më ndryshe që ka në relacion më kategoritë e tjera të trashëgimisë kulturore nuk është punuar në inventarizim dhe regjistrim të saj. Më gjithë atë institucionet kanë futur në listën e mbrojtjes së përkohshme dhjetë peizazhe kulturore. Duhet të punohet më tepër që kjo kategori e trashëgimisë kulturore të trajtohet me më shumë profesionalizëm dhe prioritet.

Prandaj, institucionet përgjegjëse duhet të kenë një qasje më serioze ndaj trashëgimisë kulturore, në ato raste kur identifikohen zbrazëtirat ligjore të adresohen për plotësim. Kur konstatohet se ligjet janë në rregull, mirëpo mungojnë sqarimet dhe procedurat adekuate, të plotësohen më akte nënligjore, të hartohen strategji të qarta për trashëgimi kulturore, të ndiqen të gjitha rastet e shkatërrimeve të trashëgimisë kulturore dhe personat përgjegjës të vihen para drejtësisë. Buxheti i ndarë për trashëgimi kulturore të menaxhohet më mirë dhe të përcaktohen mirë prioritetet shtetërore, të punohet më tepër në publikime, promovim dhe vetëdijësim publik. Po ashtu, kërkohet shtimi i numrit të projekteve dhe fondeve dedikuara trashëgimisë kulturore, shtimi i profesionistëve nga profile të ndryshme për të adresuar dhe lëruar këtë pasuri të larmishme në nivel meritore.

Republika e Kosovës duhet të punojë në ratifikimin e konventave ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore në radhë të parë për ta rregulluar gjendjen në këtë fushë dhe për t'u bërë pjesë e organizatave ndërkombëtare relevante.

2.2 Korniza ligjore

Trashëgimia kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës është e garantuar më aktin më të lartë shtetëror, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me anë të së cilës sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Gjithashtu shteti ka përgjegjësi për ta ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore dhe fetare. Ligji për trashëgimi kulturore klasifikohet ligj me interes vital për vendin.

Baza ekzistuese ligjore për KKTK

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) është agjenci e pavarur e themeluar në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është krijuar nga Kuvendi i Kosovës në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88. KKTK kompetencat dhe përgjegjësitë i ka të përcaktuara në bazë të:

Ligjit për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88

Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr. 03/L-039

Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit Nr. 04/L-066

KKTK organizimin dhe funksionin e vet e rregullon sipas akteve të brendshme normative.

Për këtë qëllim gjatë vitit 2016, KKTK ka nxjerrë këto akte nënligjore:

Rregullorja 01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Rregullorja 02/2016 për Vlerësimin dhe Shpalljen e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përhershme

Rregullorja 03/2016 për Pagesa në Terren.

Avancimi i Kornizës ligjore për punë efektive dhe efikase të KKTK

Strategjia Kombëtare për trashëgimi kulturore 2017-2027 në Objektivin 1 – Avancimi i Kornizës Ligjore dhe Institucionale ka parashikuar kompletimin e legjislacionit, harmonizimin e LTK dhe akteve tjera ligjore. Në këtë aspekt, KKTK synon që të kontribuojë konkretisht në realizimin e kësaj detyre shtetërore duke adresuar në dokumentin e strategjisë së institucionit si objektivi themelor hartimin e Ligjit për KKTK, dhe kompletimin e akteve të tjera nënligjore. Në këtë mënyrë bazuar në orientimet strategjike që ka deklaruar Republika e Kosovës, KKTK ofron mbështetje drejt kompletimit të kuadrit ligjor për strukturimin sistematik dhe rrjetëzimin efektiv të institucioneve të trashëgimisë kulturore.

Duke u bërë hisedar i rëndësishëm në marrjen e përgjegjësisë ligjore të akorduara nga Kuvendi i Kosovës, KKTK me anë të realizimit të synimeve të deklaruara në këtë dokument strategjik do të fuqizojë rolin institucional dhe atë shtetëror përmes plotësimit të pjesës së saj të detyrimeve dhe autorizimeve me të cilat është e ngarkuar në kuadër të sistemit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Kuadri ligjor për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore

Në relacion më ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore, Republika e Kosovës ka këtë kuadër ligjor primar:

Ligji për Trashëgimi Kulturore

Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe

Ligji për Fshatin Zym i Hasit

Si kuadër ligjor që me fushëveprimtarinë e vet prekë trashëgiminë kulturore por mund të konsiderohen si sekondare janë edhe këto ligje:

Ligji për Planifikim Hapësinor

Ligji për Ndërtim

Ligji për Arkivat

Ligji për Arkivat Shtetërore

Ligji për Bibliotekat

Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

Ligji nr. 03/1-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Ligji nr. 03/1-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Ligji nr. 04/1-176 për Turizmin

Ligji nr. 03/1-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës

Ligji nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz me Interes të Veçantë Nacional

Ligji nr. 02/1-68 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e Tjera

Kuadri nënligjor që rregullon mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore

Për menaxhimin, administrimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, Institucionet përgjegjëse (MKRS dhe KKTK) kanë nxjerrë akte nënligjore të cilat mundësojnë menaxhimin dhe administrimin më efikas të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës.

Aktet nënligjore të cilat rregullojnë fushën e trashëgimisë kulturore janë:

- Rregullorja 01/2008 Mbi Procedurat për Gërmime Hulumtime Arkeologjike
- Rregullorja 02/2008 Mbi Qasjen Publike ne Trashëgiminë Kulturore në Pronësi Private

- Rregullorja 03/2008 Mbi Aktivitetet Konservuese dhe Restauruese të Trashëgimisë Kulturore
- Rregullorja 04/2008 Mbi Autorizimet dhe Kompetencat e Institucionit të Trashëgimisë Kulturore
- Rregullorja 05/2008 Mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje
- Rregullorja 06/2008 Mbi Masat e Sigurisë për Trashëgiminë e Luajtshme
- Rregullorja 07/2008 Mbi Procedurat e Licencimit për Tregtarët e Objekteve të Trashëgimisë se Luajtshme
- Rregullorja 02/2016 Për Vlerësimin dhe Shpalljen e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përhershme

Vështirësitë që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit

Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KKTK gjatë punës së tij në raste të caktuara kanë ndikuar në uljen e efikasitetit dhe përmbushjes së objektivave. Moszbatueshmëria e Ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe e ligjeve tjera të aplikueshme që ndërlidhen me fushën e mbrojtjes ligjore ka reflektuar dukshëm në mospërmbushjen e objektivave kyçe të fushës.

Mungesa e bashkëpunim adekuat ndërinstucional rreth mbrojtjes ligjore të trashëgimisë kulturore ka rezultuar me dobësi evidente rreth ruajtjes dhe mbrojtjes së saj. Në këtë kuadër edhe KKTK ka hasur në vështirësi gjatë realizimit dhe zbatimit të kompetencave në përmbushjen e misionit të tij. KKTK disa herë ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse bashkëpunim me qëllim të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore.

Mosvlerësimi i projekteve nga KKTK, bënë që prioritetet në trashëgimi kulturore të orientohen keq dhe në raste të shumta projektet që realizohen në trashëgimi kulturore dështojnë, gjendja e aseteve vazhdon të jetë e rëndë, me monumente të mbyllura ose të papërfunduara që shkojnë drejt shkatërrimit.

2.3 Struktura organizative e KKTK

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) përbëhet nga Bordi prej shtatë (7) anëtarëve dhe Sekretariati prej nëntë (9) nëpunësve civil të karrierës. KKTK udhëhiqet nga kryetari i cili zgjidhet nga Anëtarët e Bordit. Sekretariati udhëhiqet nga Udhëheqësi Ekzekutiv i cili është përgjegjës për të gjitha punët administrative dhe punët përditshme të KKTK-së.

Burimet Njerëzore

KKTK është përballur me vështirësi me plotësimin e pozitave të lira të punës dhe rritjen e numrit të stafit të nevojshëm. Bazuar në këtë numër të vogël të punëtorëve, KKTK ka nevoja urgjente për plotësimin e të paktën, pesë (5) pozitave të punës gjatë periudhës 2017-2022 me qëllim të përmbushjes së objektivave themelore.

Në bazë të Rregullores 01/2016 Për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është paraparë krijimi i këtyre Departamenteve: Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, Departamenti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Departamenti i Peizazheve Kulturore, Departamenti i Gjeobazës, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa. Procesi i rishikimit dhe plotësim – ndryshimit të këtyre departamenteve është i vazhdueshëm me qëllim të riorganizimit më të mirë dhe praktik të tij.

KKTK ka mbështetur në vazhdimësi ndjekjen e trajnimeve, për të punësuarit dhe ka organizuar punëtori, konferenca e vizita studimore ne institucionet e fushës së trashëgimisë kulturore brenda dhe jashtë vendit. Si rezultat i këtyre trajnimeve, janë ngritur dhe përforcuar kapacitetet e stafit në përgjithësi, duke mundësuar zbatimin e politikave të avancimit dhe të zhvillimit në karrierë. Si rezultat i numrit të vogël të stafit, KKTK është detyruar që këta ti ngarkojë me detyra shtesë të shumta të cilat kanë paraqitur stërngarkesë në punë si dhe vështirësi në kryerjen e detyrave të shumëllojshme në të njëjtën kohë.

Megjithë buxhetin e pamjaftueshëm për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve trajnuese që e kufizon KKTK ne këtë aspekt, ekziston vullneti i personelit dhe përkushtimi i institucionit për ngritje të vazhdueshme profesionale.

2.4 Buxheti/financat

KKTK është organizatë buxhetore me kod organizativ 246 dhe me një (1) program 25600.

Në bazë të Ligjit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2017 KKTK kishte buxhet prej 196,592.00 euro dhe numri i aprovuar i stafit ishte 16 zyrtarë.

Struktura e buxhetit të aprovuar për vitin 2017 është e ndarë në kategoritë ekonomike:

Paga dhe mëditje 108,624.00 euro

Mallra dhe shërbime 85,418.00 euro

Shpenzime komunale 2,550.00 euro

KKTK përkundër shumë kërkesave të parashtruara pranë institucioneve përgjegjëse nuk ka pasur buxhet shtesë gjatë këtij viti.

Kodi Ekonomik	2017	2018	2019	2020
Total	196,592.00	197,341.00	198,426.94	198,426.94
Nr. i punetoreve	16	16	16	16
Pagat dhe Meditjet	108,624.00	109,373.00	109,919.94	109,919.94
Mallrat dhe Sherbimet	85,418.00	85,418.00	85,957.00	85,957.00
Shërbime komunale	2,550.00	2,550.00	2,550.00	2,550.00

Tabela 2. Buxheti 2017-2020

Strategjia e KKTK 2017-2022 është e ndërlidhur me Programin e Qeverise se Republikës se Kosovës 2015 - 2018, konkretisht ne piken 4.2.3. Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, ku KKTK obligohet të kryejë detyra konkrete.

Gjithashtu, veprimtaria e KKTK është e ndërlidhur edhe me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), ku Qeveria e Republikës se Kosovës ne kuadër të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes se Stabilizim Asociimit ne Kapitujt 23, 24, 25, 26 dhe 27 ka parapare detyra dhe përgjegjësi për KKTK. Ne kuadër te këtij plani përgjegjësitë e KKTK paraqiten ne pjesën MATRICA E MASAVE AFATSHKURTRA pika 3.24 Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore.

Mungesa e mjeteve buxhetore ndikon dhe vështirëson realizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e objektivave të cilat reflektojnë në gjendjen e trashëgimisë kulturore në përgjithësi.

2.5. Infrastruktura, teknologjia, komunikimi

KKTK është e vendosur në kontejnerët pranë ndërtesës së ish Rilindjes dhe gjendet në kushte të papërshtatshme të punës. Hapësira e pamjaftueshme dhe infrastruktura për zyra të reja paraqitet si kërkesë urgjente me qëllim të realizimit të misionit dhe aktiviteteve të KKTK. Prandaj duke pas parasysh gjendjen e keqe dhe amortizimin funksional të kontejnerëve, KKTK synon që të akomodohet në një objekt të përshtatshëm, aset të trashëgimisë kulturore si monument reprezentativ.

KKTK zhvillon punë në terren dhe përgjatë vizitave në asetet e trashëgimisë kulturore ka probleme të qasjes, nevojiten vetura të përshtatshme për punë në terren. Kërkohej të bëhet edhe ndërrimi i inventarit, mobileve të zyrës.

Gjithashtu, krijimi i një qendre server-room me kapacitete të mjaftueshme për ruajtjen e të dhënave dhe lehtësimin e punës është imperativ i kohës. Për të thjeshtësuar dhe lehtësuar procesin e aplikimit për shpallje në mbrojtje të përhershme, KKTK do të implementojë formën e aplikimit online. KKTK do të krijojë sistemin Web GIS për asetet e shpallura. Brenda periudhës 2017-2022 do të avancohen të gjitha pajisjet e IT për realizimin e infrastrukturës së qëndrueshme dhe të sigurte teknologjike për zhvillimin e veprimtarisë dhe punës së KKTK.

Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm është një prej elementeve më të rëndësishme për funksionimin e mirëfillte të KKTK. KKTK synon që gjithë veprimtarinë ta zhvillojë në mënyrë të hapur, publike dhe transparente dhe të krijojë një platformë interaktive si dhe rrjete sociale. KKTK ka uebfaqen e tij në të cilën publikon të gjitha vendimet dhe aktivitetet.

3. Objektivat

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore KKTK për të arritur përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë përgjatë viteve 2017 – 2022, ka nxjerrë gjithsej pesë (5) objektiva kryesore si në vijim:

1. Përmirësimin i gjendjes trashëgimisë kulturore; 2. Fuqizimi i KKTK (zhvillimi institucional);
3. Sigurimi i mbështetjes financiare për avancimin dhe përmirësimin e performancës së KKTK;
4. Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare dhe 5. Transparenca dhe komunikimi me publikun.

1. Përmirësimi i gjendjes së trashëgimisë kulturore (*realizimi i mandatit ligjor – detyrave kryesore*)

- 1.1. Trajtimi dhe qasja profesionale gjatë procesit të vlerësimit të aseteve për shpallje në mbrojtje të përhershme
- 1.2. Përcaktimi i prioriteteve financiare për trashëgimi kulturore
- 1.3. Trajtimi dhe vlerësimi profesional i projekteve të trashëgimisë kulturore
- 1.4. Trajtimi dhe vlerësimi profesional në rastet e shpronësimit dhe shitblerjeve të aseteve
- 1.5. Parandalimi i dëmtimit të trashëgimisë kulturore

Në kuadër të Objektivit 1. Përmirësimi i gjendjes trashëgimisë kulturore, do të realizohen disa aktivitete konkrete të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore.

1.1. Trajtimi dhe qasja profesionale gjatë procesit të vlerësimit të aseteve për shpallje në mbrojtje të përhershme. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit paraqet pran KKTK propozimet për vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme. Bazuar në propozimet e MKRS, KKTK më qasje profesionale do të trajtoj të gjitha propozimet e paraqitura dhe në afate ligjore do të merr vendime. Të gjitha asetet e propozuara do të trajtohen në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare.

1.2. Përcaktimi i prioriteteve financiare për trashëgimi kulturore. Në përputhje me Ligjin për Trashëgim Kulturor neni 4.9, KKTK në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me politikat zhvillimore do të përcaktoj prioritetet vjetore financiare. Përcaktimi i drejt i këtyre prioriteteve do

të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës

1.3. Trajtimi dhe vlerësimi profesional i projekteve të trashëgimisë kulturore. Në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore neni 5.2, KKTK do të vlerësojë të gjitha projektet në mënyrë të drejtë dhe profesionale. Vlerësimi i drejt dhe profesional do të ndikojë që gjendja e aseteve të trashëgimisë kulturore të jetë më e mirë. Gjatë vlerësimit të projekteve do të angazhohen edhe ekspert të fushës në vartësi të projektit.

1.4. Trajtimi dhe vlerësimi profesional në rastet e shpronësimit dhe shitblerjeve të aseteve. Duke pas parasysh se vlerësimi i çmimit të tregut në rastet e shitë – blerjeve të aseteve të trashëgimisë kulturore është mjaft e ndjeshme, KKTK do të angazhohet që këtë ta bëjë më profesionalizëm dhe pavarësi të plotë të veprimit. Përmes krijimit të Komisioneve të pavarura, KKTK garanton se të gjitha rastet e shpronësimeve dhe shitblerjeve do të trajtohen në mënyrë profesionale dhe në të mirë të trashëgimisë kulturore.

1.5. Parandalimi i dëmtimit të trashëgimisë kulturore. KKTK përmes qasjes profesionale dhe aktiviteteve konkrete do të synojë që të ndërmar të gjitha veprimet për të parandaluar dëmtimin dhe shkatërrimin e trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës.

2. Fuqizimi i KKTK (zhvillimi institucional)

2.1. Avancimi i kornizës ligjore (Ligji i KKTK, rregulloret etj.)

2.2. Zhvillimi profesional i kuadrit (burimet njerëzore)

2.3. Reforma e brendshme institucionale (avancimi i strukturës KKTK)

2.4. Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike (objekti, pajisjet, TI etj.)

Zhvillimi dhe fuqizimi i KKTK, është një ndër objektivat strategjike për periudhën 2017 – 2022. Nëpërmjet fuqizimit të KKTK do të arrihet që trajtimi i trashëgimisë kulturore të jetë më profesional dhe përgjegjësitet dhe kompetencat të jenë të qarta. Në kuadër të këtij objektivi strategjik janë paraparë disa aktivitete konkrete si ne vijim:

2.1. Avancimi i kornizës ligjore (Ligji i KKTK, rregulloret etj.) Duke pas parasysh se KKTK është agjencion i pavarur i garantuar më Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Trashëgimi Kulturore, KKTK për të ruajtur pavarësinë e vetë do të ndërmar të gjitha veprimet e nevojshme. Ligji për Trashëgimi Kulturore është në proces të plotësim – ndryshimit, KKTK në momentin që

ky ligj të shkoj në Kuvendin e Kosovës për diskutim do të angazhohet të asistoj Kuvendin më rekomandime dhe sugjerime konkrete. Gjithashtu do të bëhet një analizë detale e të gjitha akteve të brendshme të KKTK, në atë raste ku identifikohen zbrazëtira do të bëhet plotësim ndryshimi si dhe do të nxjerrën akte të reja nënligjore për të gjitha çështjet që lidhen me mandatin dhe kompetencat e KKTK.

2.2. Zhvillimi profesional i kuadrit (burimet njerëzore) Zhvillimi dhe avancimi i burimeve njerëzore brenda KKTK do të jetë mjaft i rëndësishëm dhe prioritet në periudhën 2017 -2022. Do të synohet që punëtorët aktual të kenë të gjithë përgatitjet e nevojshme akademike dhe profesionale si dhe do të angazhohemi maksimalisht në rritjen e numrit të stafit të KKTK.

2.3. Reforma e brendshme institucionale (avancimi i strukturës KKTK) Në bazë të zhvillimit dhe avancimit të kornizës ligjore do të bëhet edhe reformë institucionale brenda KKTK. Përmes reformës institucionale do të synohet që të behën ndarje të qarta të përgjegjësiive.

2.4. Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike (objekti, pajisjet, TI etj.) KKTK aktualisht është e vendosur në kontejnerë më hapësirë jo të mjaftueshme të punës, kushte jo të mira dhe siguri jo e mjaftueshme. Duke pas parasysh misionin dhe mandatin që ka KKTK do të synohet që të akomodohemi në një ndërtesë të trashëgimisë kulturore. Do të shikohen të gjitha mundësit dhe do të parashtrihen kërkesa konkrete. KKTK punën e vet e ka filluar në vitin 2010 dhe pothuajse të gjitha pajisjet që ka në posedim janë të amortizuara dhe zhvlerësuara, prandaj është e nevojshme blerja dhe zëvendësimi i të gjitha pajisjeve fizike të KKTK. KKTK përdorë sistemin informativ të Kosovës, duke shfrytëzuar rrjetin dhe domenin shtetëror. KKTK nuk ka një server të vetin për menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave institucionale, nuk posedon softvere dhe hardvere të avancuar bazuar në nevojat që ka. Për siguri dhe menaxhim më efikas të gjithë punës dhe veprimtarisë së KKTK do të synohet krijimi i një rrjete të brendshme, krijimi i të paktën një serveri, zhvillimi i webgis-it, digjitalizimi i asetëve të shpallura në mbrojtje të përhershme, krijimi dhe implementimi i formës online për aplikim për shpallje në mbrojtje të përhershme

3. Sigurimi i mbështetjes financiare për avancimin dhe përmirësimin e performancës së KKTK

3.1.Rritja e vazhdueshme e buxhetit të KKTK

3.2.Aplikimi në fonde të ndryshme ndërkombëtare (programe, donacione)

3.3.Krijimi i të hyrave financiare për shërbimet e ofruara nga KKTK

KKTK për periudhën 2017 – 2020 ka buxhet në vlerë prej 790,786.88 euro, në të gjitha kategoritë ekonomike. Kjo vlerë e buxhetit për periudhën 2017 – 2020 është e pamjaftueshme për arritjen e objektivave konkrete të institucionit. Në kuadër të këtij objektiv janë paraparë disa aktivitete konkrete si në vijim:

3.1. Rritja e vazhdueshme e buxhetit të KKTK. Do të punohet më të gjitha palët dhe institucionet përgjegjëse që buxheti i ndarë për KKTK të rritet në vazhdimësi.

3.2 Aplikimi në fonde të ndryshme ndërkombëtare (programe, donacione). KKTK gjatë periudhës 2017-2022 do të indentifikojë mundësitë për aplikim në fonde, programe të trashëgimisë kulturore si IPA, Marshal Fund, Creative Europe, UNDP, USAID etj.

3.3 Krijimi i të hyrave financiare për shërbimet e ofruara nga KKTK (revista, anëtarësi në bibliotekë) KKTK planifikon të ofrojë shërbime për publikun të botimeve profesionale dhe shkencore, gjenerimin e hartave dhe informacioneve të tjera rreth trashëgimisë kulturore, pasurimi me literaturë profesionale të bibliotekës dhe krijimin e bibliotekës digjitale.

4. Anëtarësi dhe bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare

4.1. Identifikimi i organizatave ndërkombëtare për anëtarësim

4.2. Identifikimi i institucioneve ndërkombëtare për bashkëpunim

4.3. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta

KKTK në përputhje me orientimet strategjike synon anëtarësimin dhe bashkëpunimin me organizata të rëndësishme ndërkombëtare, si ICOMOS, Europa Nostra, UNESCO, ICCROM etj. Po ashtu, KKTK planifikon të organizojë aktivitete dhe projekte në bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare që zhvillojnë fushëveprimtari të ngjashme.

5. Transparenca dhe komunikimi me publikun

5.1. Vendosjen e një sistemi efikas të komunikimit të brendshëm dhe me publikun (media)

5.2. Transparenca e punës dhe veprimtarisë së KKTK

Komunikimi me publikun zhvillohet nëpërmjet mediave dhe mjeteve tjera për shpërndarje të informacionit. Veprimtaria e KKTK zhvillohet në mënyrë të hapur, publike dhe transparente. Për të promovuar punën dhe aktivitetet, KKTK shfrytëzon uebfaqen zyrtare.

4. PLANI I VEPRIMIT

Strategjia e KKTK 2017-2022 e fokusuar në arritjen e objektivave programore të institucionit për periudhën pesë (5) vjeçare, përmban Planin e Veprimit për zbatimin e saj.

Pesë objektivat kryesore të identifikuar me SWOT në dokumentin e Strategjisë, zërthehen me anë të Planit të Veprimit në kuadër të të cilit janë: 17 Masa/aktivitetet dhe 45 Indikatorë/tregues që udhëzojnë zbatimin më të lehtë të mandatit ligjor dhe avancimin e punës. KKTK përmes Strategjisë përcakton orientimin e politikave programore të fushëveprimtarisë së përbashkët me institucionet përgjegjëse për realizimin e tyre dhe rezultatet e pritura në afatet e përcaktuara.

OBJEKTIVI 1	Përmirësimi i gjendjes trashëgimisë kulturore		
Aktivite / Masat	Indikatorët	Akterët / Partnerët	Afati kohore
1.1.Trajtimi dhe qasja profesionale gjatë procesit të vlerësimit të asetëve për shpallje në mbrojtje të përhershme	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i grupeve punuese për shqyrtimin e asetëve të propozuara - Vendimmarrja lidhur me asetet e propozuara - Numri i asetëve të shpallura në mbrojtje të përhershme 	KKTK MKRS MMPH KZM	Afatgjatë (2017-2022)
1.2.Përcaktimi i prioritetëve financiarë për trashëgimi kulturore	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i listës prioritare për financim - Numri i projekteve prioritare të realizuara 	KKTK Kuvendi i Kosovës MKRS OJQ	Afatgjatë (2017-2022)
1.3.Trajtimi dhe vlerësimi profesional i projekteve të trashëgimisë kulturore	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi i grupeve punuese - Rekomandimet e grupit punues për veprim - Miratimi i raportit të grupit punues nga Bordi i KKTK 	KKTK Universiteti OJQ MKRS	Afatgjatë (2017-2022)
1.4.Trajtimi dhe vlerësimi profesional në rastet e	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi i Komisioneve të pavarura profesionale për vlerësim 	KKTK Ekspertë	Afatgjatë (2017-2022)

STRATEGJIA 2017-2022

shpronësimit dhe shitblerjeve të aseteve	<ul style="list-style-type: none"> - Raporti i vlerësimit me rekomandime - Miratimi i rekomandimeve nga Bordi i KKTK 	KKTK Ekspertë	
1.5.Parandalimi i dëmtimit të trashëgimisë kulturore	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi dhe analizimi i aseteve në rrezik dëmtimi - Promovimi i numrit telefonik pa pagesë - Denoncimi i rasteve të dëmtimit dhe shkatërrimit të trashëgimisë kulturore - Sensibilizimi në media, mjete të informimit - Miratimi i dokumentit “Parandalimi dhe Lufta Kundër Trafikimit të Trashëgimisë Kulturore” 	KKTK MKRS Prokuroria Mediat Policia Doganat AKI	Afatshkurtë (2017-2020)

OBJEKTIVI 2	Fuqizimi i KKTK		
Aktivite / Masat	Indikatorët	Akterët / Partnerët	Afati kohore
2.1. Avancimi i kornizës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi, plotësimi dhe harmonizimi i akteve nënligjore të KKTK - Propozimet e KKTK për plotësim – ndryshimin e Ligjit të Trashëgimisë Kulturore - Propozimi / rekomandimi për ratifikim të Konventave Ndërkombëtare për Trashëgimi Kulturore 	KKTK MKRS Ekspertë	Afatshkurtë (2017-2020)
2.2. Zhvillimi profesional i kuadrit	<ul style="list-style-type: none"> - Ngritja profesionale e kapaciteteve ekzistuese (burimet njerëzore) - Pjesëmarrja në takime, konferenca vendore dhe ndërkombëtare - Organizimi i punëtorive të KKTK brenda dhe jashtë vendit 	KKTK	Afatgjatë (2017-2022)
2.3. Reforma e brendshme institucionale	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i strukturës organizative 	KKTK	Afatshkurtë (2017-2020)
2.4 Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike	<ul style="list-style-type: none"> - Akomodimi në ndërtesë / objekt të përshtatshëm (aset reprezentativ i trashëgimisë kulturore) - Blerja/ sigurimi i veturave të terrenit - Blerja e inventarit për zyre - Blerja e pajisjeve të TI dhe krijimi i qendrës server-room - Krijimi i platformës për aplikim online - Krijimi i sistemit Web GIS - Përmirësimi i uebfaqes së KKTK 	KKTK MAP Kuvendi i Kosovës Donatorët	Afatshkurtë (2017-2020) Afatshkurtë (2017-2020)

OBJEKTIVI 3	Sigurimi i mbështetjes financiare për avancimin dhe përmirësimin e performancës së KKTK		
Aktivite / Masat	Indikatorët	Akterët / Partnerët	Afati kohore
3.1. Rritja e vazhdueshme e buxhetit të KKTK	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa buxhetore për plotësimin e pozitavë të lira dhe të reja, blerja e pajisjeve TI, blerja e veturave, inventarit, shërbime arsimit dhe trajnimit etj. - Realizimi i projekteve të KKTK (organizimi i punëtorive, krijimi i Geo-Bazës, Server-Room-it, platforma online etj.) 	KKTK Kuvendi i Kosovës Donatorët	Afatgjatë (2017-2022)
3.2. Aplikimi në fonde të ndryshme ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> - Themelimi i njësisë/zyrës për projekte - Projektet e mbështetura nga fonde, programe të trashëgimisë kulturore si: IPA, Marshall Fund, Creative Europe, UNDP, USAID, KE, Prince Claus Fund e donatorë të tjerë 	Donatorët	Afatgjatë (2017-2022)
3.3. Krijimi i të hyrave financiare për shërbimet e ofruara nga KKTK (revista, anëtarësimi në bibliotekë)	<ul style="list-style-type: none"> - Revista profesionale dhe informacione të trashëgimisë kulturore - Të hyra nga organizimi i konferencave ndërkombëtare - Gjenerimi i hartave interaktive për asetet e shpallura nga KKTK - Anëtarësimi në bibliotekë digjitale 	KKTK	Afatgjatë (2017-2022)

OBJEKTIVI 4	Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare		
Aktivitete / Masat	Indikatorët	Akterët / Partnerët	Afati kohore
4.1. Identifikimi i organizatave ndërkombëtare për anëtarësim	- Organizatat potenciale për anëtarësim ICOMOS, ICCROM, Europa Nostra, etj.	KGTK	Afatshkurtë (2017-2020)
4.2. Identifikimi i institucioneve ndërkombëtare për bashkëpunim	- UNESCO, KiE, OSCE, UNDP, etj.	KGTK GIZ TIKA	Afatshkurtë (2017-2020)
4.3. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta	- Organizimi i projekteve, aktiviteteve dhe bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare	KGTK Organizata Ndërkombëtare	Afatgjatë (2017-2022)

OBJEKTIVI 5	Transparenca dhe komunikimi me publikun		
Aktivite / Masat	Indikatorët	Akterët / Partnerët	Afati kohor
5.1. Vendosija e një sistemi efikas të komunikimit të brendshëm dhe me publikun	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi dhe vetëdijesimi i publikut për rolin e KKTK-së në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore - Organizimi i konferencave për shtyp lidhur për realizimin e detyrave të KKTK 	KKTK Mediat	Afatshkurtë (2017-2020)
5.2. Transparenca e punës dhe veprimtarisë së KKTK	<ul style="list-style-type: none"> - Përditësimi i veprimtarisë së KKTK përmes uebfaqes, rrjeteve sociale, mediave - Informim i publikut për shpalljen, vlerësimin e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme 	KKTK Mediat	Afatgjatë (2017-2022)